Që nga kohët më të vjetra molla është personifikuar me shëndetin, bukurinë, rininë dhe frytnimin. Kështu njeriu, duke iu falenderuar aftësisë së të menduarit, është ngritur në aspektin kulturor, është përpjekur që me psikën e tij të depërtojë në fshehtësitë e jetës së bimëve, pemëve, që t'u besojë disa qenieve të çuditshme të cilat me rrënjën e

tyre dhe gjethet e gjelbra formojnë fryte të ëmbla dhe aromatike, shumë të nevojshme për mbajtjen e shëndetit dhe jetës në përgjithësi.

Kultivimi i pemëve mbron tokën nga erozioni. Në të njëjtën kohë pemët kanë veprim dekorativ dhe kanë vlerë të lartë teknike në industrinë e drurit.

Pemët kanë vlera të larta ushqyese për organizimin e njeriut të të gjitha moshave. Për këtë arsye preferohet që njeriu gjatë ditës të konsumojë 315 g fruta pemësh. Hulumtimet për materiet e pektinit që gjendet në frutat e pemëve flasin se ato e pengojnë grumbullimin e kolesterolit në enët e gjakut dhe kështu pengojnë sëmundjet e rrezikshme të arteriosklerozës dhe nfarktit. Andaj lirisht mund të themi:

NJË MOLLË NË DITË, I THOTË MJEKUT IK.



Kuizi në konvikt Faton Kabashaj

Për nder të njëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në konviktin e ALG-së është organizuar një kuiz i cili është mbajtur gjatë muajit shkurt dhe është realizuar brenda 10 ditëve.

Përgatitjen e pyetjeve dhe realizimin teknik e ka bërë edukatori Faton Kabashi, ndërsa vlerësimin e pikëve e ka bërë komisioni i përbërë nga m. Hana Kqira, ed. Filomena Laçi dhe ed. Fejzullah Morina. Përmbajtja e kuizit ka qenë nga këto lëndë:

gjuhë shipe, matematikë, fizikë, kimi, biologji, histori, gjeografi dhe pyetje të ndryshme (art, muzikë, sport ...).

Kuizi është organizuar në dy kategori.

Në kategorinë e parë kanë marrë pjesë nxënësit e klasave VI, VII dhe VIII, ndërsa në kategorinë e dytë kanë marrë pjesë nxënësit e klasave IX, X, XI dhe XII. Në kuiz kanë marrë pjesë 26 grupe të nxënësve (secili grup është përbërë nga 3 nxënës). Përkatësisht 5 grupe kanë garuar në kategorinë e parë dhe 21 grupe në kategorinë e dytë. Qëllimi i kuizit ka qenë që të shikohet niveli i njohurive të nxënësve, të përvetësojnë njohuri të reja, që të kenë një jetë më zbatimëse në konvikt etj. Fituesit e kuizit janë shpërblyer me mirënjohje dhe me disa dhurata simbolike. Fituesit e kuizit janë:

Kategoria e parë: Nikë Raja, Gent Polloshka, Krist Allakaj

Kategoria e dytë: Gazmend Maksutaj, Donik Karaqi, Shaip Gashi



Jeta e vajzave në konvikt Arta Musollaj X d

Konvikt



Si çdo fillim, edhe fillimi i jetës në konvikt për ne vajzat ishte i vështirë. Shumë nga ne nuk ishim mësuar që të qëndronim larg familjeve tona, mirëpo kishte ardhur koha që të fillonim një jetë paksa më ndryshe; të jemi më të pavarura dhe të mund t'i përballojmë vetë sfidat e jetës.

Kur erdhëm në konvikt, për ne filloi një jetë pothuajse e re. Çdo gjë ishte më ndryshe dhe dallonte nga jeta që ishim mësuar të bënim. Në konvikt çdo gjë bëhet me orar të caktuar dhe sipas rregullave. Kushtet e konviktit janë shumë të mira dhe vështirë se mund të ankohet dikush për to. Aty kemi çdo gjë çfarë na nevojitet për një jetë normale.

Fillimi barti me vete mungesën e familjeve tona, mirëpo duhej ta përballojmë këtë gjë në mënyrë që të mund të shkollohemi në një shkollë që ka vlera dhe nga e cila pritet një e ardhme më e mirë. Javën e parë fytyrat e vajzave ishin të vrenjtura, dukeshin të ndrojtura nga çdo gjë dhe buzëqeshjen e shfaqnin vetëm atëherë kur familjarët vinin t'i vizitonin.

Përveç të tjerash, na shqetësonin mendimet se si do t'ia kalonim së bashku sepse ende nuk njiheshim mirë dhe nuk dinim pothuajse asgjë për njëra-tjetrën. Mirëpo koha filloi t'i ndryshojë gjërat dhe në çdo ditë që kalonte, më shumë e njihnim njëra tjetrën. Dalëngadalë filluam ta gjejmë veten dhe të mësohemi në këtë bashkësi të re e cila tani pothuajse është si një familje e re për ne.

Mësimi që e bëjmë në konvikt është mjaft efektiv, duke marrë parasysh faktin se të gjitha vajzat e grupit mësojmë së bashku. Kjo na mundëson të kemi ndihmën e njëra-tjetrës në rast të ndonjë paqartësie eventuale në lëndë të ndryshme. Përveç mësimit, ne gjejmë kohë edhe për aktivitete të ndryshme, p.sh për të shikuar televizor, për të përgatitur diçka apo për të luajtur ndonjë lojë.

Të mbledhura të gjitha së bashku dukemi si një familje e madhe e cila gjen argëtim ndermjet anëtarëve të saj. Pra, siç shihet, një fillim paksa i vështirë, në fund po na shpërblehet me krijimin e një rrethi të shëndetshëm shoqëror, i mbushur me vlera edukativo-arsimore, nga i cili pritet shumëçka në të ardhmen.



Më në fund arrita ... Anita Bala VII b

Më në fund arrita ...

*Shoh ca vje dhe mendoj:
"A thua ndonjë ditë do të t'takoj?"
Shoh një ëndërr pa kuptim,
kah më shfaqet frikësimi im
Eci rrugës me shpejtim,
duke menduar se ti je te shtrati im
Eci rrugës me frikësim,
duke menduar se ti s'je tek shtrati im.
Hapa rrugën për takim,
gjeta mënyrën për një përqaftim.
Gjeta çelësin që me kohë e kam kërkuar,
gjeta dashurinë që përherë kam ëndërruar.
Hapa zemrën dhe të gjeta.
Ishe pranë, por unë nuk të vëreja.
Nuk të vëreja, sepse s'të kërkova.
S'të kërkova, sepse tek ti mendova.
Zgjata dorën, por s'të arrita.
Hyra brenda, por rrëshqita,
u rrëzova dhe dot nuk u ngrita.
Hapa zemrën dhe më në fund arrita.*

Konvikt



25.01.2009 - ALG-Ausflug nach Brezovica Blend Arllati und Leonard Pnishi XII b



Die Nachricht, dass wir am Sonntag nach Brezovica gehen würden, freute mich sehr. Für mich war es das zweite Mal, dass ich nach Brezovica gehen würde. Ich war dort auch im vergangenen Jahr, wo ich einen sehr schönen und interessanten Tag verbrachte. Auch den Aufstieg zur Spitze des Berges, gemeinsam mit Leonard Pnishi, hatte ich nicht vergessen. Von dort oben hatten wir einen wunderschönen, fantastischen und unvergesslichen Ausblick auf die Landschaft.

Nachdem wir hörten, dass wir dieses Jahr wieder nach Brezovica gehen würden, entschlossen wir uns, wieder zu Fuß auf die Spitze des Berges zu steigen, aber dieses Mal, dachten wir, sollte es etwas spezieller als das letzte Mal sein. So kam mir die Idee, das Logo unserer Schule auf den Schnee zu malen, und das auf der Spitze des Berges. Leonard war mit dieser Idee einverstanden, und auch unsere Erzieherin, die uns das benötigte Material besorgte, um diese Idee zu verwirklichen.

Nachdem wir in Brezovica angekommen waren, fuhren Leonard und ich mit einem Skilift, damit wir uns für einen Platz entscheiden konnten, wo wir das Logo malen wollten. Als wir wieder runterstiegen, gingen wir etwas essen und dann endlich, um zwei Uhr am Nachmittag, fingen wir an hochzuklettern. Der Aufstieg war ein unbeschreibliches Gefühl. Wir fühlten die Müdigkeit unserer Beine gar nicht, trotz des so steilen Weges und des weichen Schnees, der den Aufstieg noch schwerer machte. Aber irgendwann kamen wir zu der Stelle, die einige Meter unterhalb der Bergspitze lag. Als wir ankamen, packten wir sofort unsere Spraydosen aus und fingen an, das Logo zu malen.

Die Stelle, die wir uns ausgesucht hatten, befand sich unter dem Skilift, so dass alle, die mit dem Skilift über uns hinweg fuhren, sehen konnten, was wir machten. Fast alle fragten uns, was wir dort unten machten. Einige dachten sogar, dass wir unsere neue Flagge malten, da wir mit Blau, Gelb und Grau malten. Wir bekamen auch sehr viele Komplimente, ein paar Leute machten sogar Fotos von uns oder nahmen uns mit ihren Kameras auf. Das war ein wirklich gutes Gefühl.

Als wir das Logo zu Ende gemalt hatten, kamen noch ein paar Freunde, ein Lehrer und ein Erzieher vorbei. Danach machten wir noch ein paar gemeinsame Fotos und dann, sehr zufrieden mit unserem Werk, machten wir uns auf den Weg nach unten, wo alle anderen auf uns warteten, um ins Internat zu fahren.



25.01.2009 - ALG në Brezovicë Blend Arllati dhe Leonard Pnishi XII b

Lajmi që të dielën do të shkonim në Brezovicë, më gëzoi shumë. Për mua do të ishte hera e dytë që do të shkoja në Brezovicë. Unë isha edhe vitin e kaluar atje, ku kalova një ditë shumë të bukur dhe interesante. Vlen të përmendet ngjitja deri në majën e malit të Brezovicës në këmbë së bashku me Leonard Pnishin. Nga atje lart pamë disa pamje tejet të bukura, fantastike dhe të paharrueshme të peisazhit.

Kështu që me të dëgjuar lajmin se këtë vit do të shkonim prapë në Brezovicë, ne vendosëm që të ngjiteshim prapë në këmbë deri në majën e malit. Por këtë herë menduam që të jetë diçka më e veçantë se herën e kaluar. Kështu më lindi ideja për ta vizatuar logon e shkollës sonë në borë në majë të malit. Leonardi u pajtua menjëherë me idenë. Po ashtu edhe edukatorja jonë, e cila na siguroi materialin e duhur për ta realizuar këtë ide.

Me të arritur në Brezovicë, së bashku me Leonardin hipëm në teleferik për ta caktuar vendin se ku do ta vizatonim logon. Pasi u kthyem prapë poshtë, shkuam për të ngrënë drekë dhe më në fund, rreth orës dy pasdite, filluam ngjitjen. Ngjitja lart ishte një ndjenjë e papërshkrueshme. Ne nuk e ndjenim fare lodhjen e këmbëve tona, përkundër pjerrtësisë së madhe dhe borës së butë që e bënin ngjitjen edhe më të vështirë. Dalëngadalë ne arritëm tek vendi që kishim caktuar. Kishte edhe disa dhjetëra metra për të arritur në majën e malit. Me të arritur aty, menjëherë nxorëm nga çanta ngjyrat (në formë spreji) dhe filluam vizatimin e logos.

Vendi që kishim caktuar gjendej nën teleferik, kështu që çdo vizitor që hipte në të mund ta shihte logon që po vizatonim. Gati të gjithë na pyesnin se çfarë ishim duke vizatuar. Disa pyesnin mos ishte flamuri i shtetit tonë, pasi ishte me ngjyrë të kaltër, të verdhë dhe të përhimtë. Po ashtu na jepnin edhe komplimente, na bënin fotografi nga lart, disa inçizonin me kamerat e tyre etj. Ishte vërtet një ndjenjë shumë e mirë.

Pasi përfunduam vizatimin e logos, erdhën disa shokë tanët, profesori i edukatës fizike dhe një nga edukatorët, të cilët po skijonin dhe bëmë disa fotografi së bashku. Në fund, të kënaqur nga puna që kishim bërë, Leonardi dhe unë u nisëm poshtë malit ku të tjerët po na prisnin për t'u nisur për në konvikt.



Internat

Një mbrëmje e bukur në "Pulaj" Cjerolinda Desku XI a

Konviktore



Jeta është shumë e bukur kur njeriu di ta shfrytëzojë. Surprizat dhe gëzimet në konvikt të "Loyola-Gymnasium" janë po aq të bukura sa edhe jeta. Një mbrëmje e papritur tek restoranti n'afërsi të shkollës ishte një

befasi dhe një mbrëmje e bukur gjithashtu. Së bashku me edukatoren gjatë rrugës vazhdimisht bisedonim dhe secila nga ne shprehte mendimet e veta, kënaqësitë dhe pakënaqësitë.

Shumica thonim se kjo darkë do të jetë jo argëtuese dhe ndoshta e mërzitshme. Kështu biseda vazhdoi deri kur hymë në restorant dhe u ulëm. Ishte shumë qesharake dhe argëtuese mënyra se si ishim ulur. Kishim vendosur tryezat dhe karriget në formë të shkronjës "L" dhe dukeshim tamam sikur ishim duke mbajtur ndonjë mbledhje shumë të rëndësishme. Më vonë e kuptuam se edhe një darkë e shijshme tek një restorant i vogël dhe jo shumë larg shkollës e konviktit mund të jetë shumë argëtuese dhe stres-heqëse. Ishte mbrëmje shumë e bukur. Vërtet ia kaluam shumë mirë dhe i tërhoqem fjalët e mëparshme që i kishim thënë.

Uroj që edhe mbrëmjet e tjera që do të organizohen të jenë po aq të mira dhe aq argëtuese sa edhe mbrëmja e lartshënuar. Ndoshta jeta në konvikt është paksa e rëndë, por s'është diçka që nuk mund të tejkalohet. Edhe konvikti ka anët pozitive dhe negative të tij, por anët pozitive janë ato që dominojnë.

Eine sehr gute Lehrerin und Freundin Meriton Lubishtani XII c

Melissa war eine sehr gute Lehrerin und Freundin. Als deutsche Praktikantin besuchte sie unsere Schule ein Semester lang. Da sie jung war, hatten wir die Möglichkeit, sie auch als Freundin zu haben. Die verschiedenen Aktivitäten, die sie mit uns unternommen hat, haben die Teamarbeit noch mehr verstärkt. Melissa war jederzeit bereit, uns mit der deutschen Sprache zu helfen, vor allem, wenn wir eine Klassenarbeit vor uns hatten.

Ihr Lieblingssport war Boxen. So hat sie sich bereit erklärt, uns in der Freizeit Boxen zu lehren. Wir konnten in der kurzen Zeit wenigstens einige Boxerfahrungen machen.

Bevor Melissa wieder nach Hause ging, organisierten die Kinder aus dem Internat einen Abschiedsabend für sie und einige Gäste. Für den Abend hatte ich Melissas Foto mehrmals vergrößert und in der Mensa aufgehängt. Beim Aufhängen des Bildes mit der Überschrift "We will miss you" haben mir die Jungs meiner Gruppe geholfen. Da es aber eine Überraschung sein sollte, hatten wir es mit einem schönes Papier verdeckt. Bevor dann das Programm zu Ende war, baten wir Melissa, nach vorne zu kommen, und haben ihr die Überraschung gezeigt. Sie hat sich darüber sehr gefreut und es war ein wichtiger Moment für unsere Freundschaft.

Am nächsten Tag waren es sehr traurige Minuten, als wir uns von unserer guten Freundin verabschieden mussten. Wir haben aber immer noch Kontakt zu ihr, obwohl sie weit von uns entfernt ist.

Konvikt

Mësuese dhe shoqe e mirë

Konviktore



Mësuese dhe shoqe e mirë. Ishte praktikante nga Gjermania që erdhi këtu në shkollën tonë. Ajo ishte e re patëm mundësinë ta kemi mike dhe shoqe shumë të mirë. Banimi në konvikt na ofroi më shumë me të. Mundësia të zhvillojmë aktivitete të ndryshme këtu në kuadër të konviktit, na mundësoi që të lidhemi më shumë me të. Mbi të gjitha Melissa ishte gjithmonë e gatshme të na ndihmonte në gjuhën gjermane, sidomos atëherë kur kishim hallin e testit. Ishte shumë e qartë dhe e kuptueshme.

Si sport të preferuar ajo kishte boks. Kështu shprehu vullnetin që gjatë kohës së lirë të na ushtronte edhe ne në boks. Por ajo qëndroi këtu për një kohë jo shumë të gjatë, kështu që ne mësuam vetëm gjërat elementare dhe fillestare në boks.

Afërsia dhe çelhtësia e saj bënë që të krijojmë raporte shumë të afërta me të. Ishte bërë si familjare e jona. Kjo bëri që të mërzitemi pak për shkuarjen e saj. Një natë para se të shkonte organizuam në konvikt një program për disa mysafirë. Për këtë natë kisha përgatitur një fotografi të saj të zmadhuar, për ta ngjitur në mur (në mensë) aty ku do të mbahej programi. Bashkë me grupin e ngjitëm në mur me mbishkrimin "Ëe vill mis you", e mbuluam me një letër që t'ia zbulonim më vonë si befasi. Pas programit i thamë të afrohej dhe ia zbuluam fotografinë. Emocionet ishin të pashmangshme si për të, ashtu edhe për në. Ishte moment prekës, por shumë domethënës për miqësinë tonë.

Të nesërmen, kur u përshëndetëm me të, ndjemë që një shoqe e mirë e jona po na largohej. Tani ende mbajmë kontakte dhe miqësia jonë ende vazhdon të jetë e mirë edhe nga largësia.



Geburtstag im Internat Lumbardh Haxhishabani XII c



Der 18. Geburtstag ist ein besonderer Geburtstag, denn wenn man dieses Alter erreicht, gilt man als erwachsen. Das Besondere an meinem 18. Geburtstag war zudem, dass mein Freund aus meiner Gruppe, Ylber, am gleichen Tag Geburtstag hat. Wir wussten, dass dieser Geburtstag anders sein würde als alle anderen vorher und deswegen konnten wir es kaum erwarten, dass der Tag kam. Wir wollten im Internat feiern, denn wir

konnten nicht mit allen unseren Freunden in die Stadt. Mit der Hilfe unserer Erzieherin organisierten wir unseren Geburtstag so gut wie möglich.

Wir hatten gehört, dass unsere Erzieherin eine Überraschung für uns hatte, aber wir hatten keine Idee, worum es ging. Ich hatte Schmetterlinge im Bauch, als ich an den großen Tag dachte. Ich wollte endlich wissen, was meine Überraschung ist. Das gleiche dachte sich auch Ylber.

Endlich war er da. Mein Geburtstag. Der Tag fing mit Glückwünschen und Geschenken von unseren Liebsten, mit denen wir jeden Tag zusammen verbringen, unseren Freunden, an. Nach dem Unterricht wurden die Vorbereitungen für das Fest immer intensiver, mit dem Ziel, einen möglichst unvergesslichen Abend zu erleben.

19:30 Uhr - Der langerwartete Moment war gekommen. Zusammen mit unseren Freunden gingen wir in den Saal, wo wir unser Fest vorbereitet hatten, und ... Überraschung! Ernest Malazogu, ein bekannter Schauspieler, stand vor uns. Er ist bekannt für seine Rolle als "Fisnik" in der Serie "Eine moderne Familie". Das hätten wir niemals erwartet. Wir waren sehr froh darüber. Wir sprachen mit ihm und konnten ihn alles fragen, was uns an ihm und seiner Rolle interessiert.

Nachdem wir ein bisschen Zeit mit ihm verbracht hatten, machten wir mit dem Feiern weiter. Es gab Musik und wir tanzten sehr viel. Die Torte war auch sehr köstlich. Das war unser besonderer Geburtstag. Ylber und ich werden ihn nie vergessen. Es war das erste Mal, dass wir so eine Überraschung erlebt haben.

Ditëlindja në konvikt

Ditëlindja e 18-të është ditëlindje e veçantë sepse kur arrihet kjo moshë, je më i pjekur dhe duhet menduar më seriozisht. E veçantë ishte se unë kisha ditëlindjen bashkë me shokun tim të grupit, Ylberin. E dinim që do të ishte një ditëlindje më ndryshe nga të tjerat dhe mezi e prisnim. Ditëlindjen kishim për ta festuar këtu në konvikt. Kështu, me ndihmën dhe përkrahjen e edukatores, ne e organizuam si është më së miri festën tonë.

Kishim dëgjuar për një surprizë që do të na bënte edukatorja, por nuk e kishim idenë se çfarë do të ishte. "Fluturat" sa vinin e më silleshin më shumë në bark kur dita e festës afrohej. Doja të kuptoja surprizën; nuk e kisha idenë se ç'mund të ishte. Të njëjtën donte të dinte edhe Ylberi.

Ditëlindja erdhi. Dita filloi me urime e dhurata nga më të dashurit tanë, nga ata që ne çdo ditë e ndajmë bashkë, shoqëria. Gjatë ditës, pas mësimit, përgatitjet për festën vinin e bëheshin më të shpeshta, duke synuar që si rezultat të jepnin një përjetim të vërtetë që s'do ta harronim. Ajo surprizë po më ngrinte adrenalinën çdo çast e më shumë. E shumëpëritura erdhi.

Ora 19:30. Bashkë me shokët shkuam në sallën ku do të festonim dhe ... befasia shpërtheu! Ernest Malazogu, aty ishte një aktor i famshëm i yni. Ai është i famshëm tek ne me rolin e Fisnikut në serialin "Familja moderne". Vërtet që diçka që unë dhe Ylberi as që e kishim menduar. U gëzuam dhe na erdhi shumë mirë. Pastaj patëm rastin të flisnim me të për së afërmi dhe ta pyesim për çdo gjë që na interesonte për të dhe rolin e tij.

Kaluamnjaf kohë me të dhe vërtet u kënaqëm. Vazhduam festën më pas me muzikë dhe vallëzim. Gjithashtu edhe torta që e këndshme. Kjo ishte ditëlindja jonë më e veçantë. Unë dhe Ylberi gjithmonë do ta mbajmë në mend. Befasia ishte e para e llojit të tillë për ne.



Internat

Një vizitë në bodrumin e verës, Rahovec Gresa Kabashi IX b

Konviktore



Ndoshta vendi ynë nuk është i përsosur. Në fakt, ka shumë gjëra që do të mund të kishim qenë më mirë. Gjithsesi, Kosova ka mjaft gjëra për të cilat ne mund të jemi krenarë. Vizitat që bëjmë me arsimtarët tanë në disa vende jonatyrore na bëjnë ne nxënësve më të vetëdijshëm. Besoj se në një nga këto vizita me vlerë mund të përfshijmë edhe vizitën tonë në bodrumin e verës në Rohavec.

Udhëtimi nuk ishte i gjatë, as shumë i vështirë, megjithëse ishte dimër. Sapo mbërritëm unë vëreja se ndërtesa ishte e vjetër, por kishte diçka tërheqëse në të. Sesi më dukej; si një muze i kohëve të lashta. Ne u futëm brenda së bashku. Një punëtor i bodrumit u bë ciceroni ynë.

Filluam të ecnim. Përpara na dolën disa fuqi të drunjtja, për të cilat mësuam se ishin enët e barikut. Pas këtyre ne pamë disa fuqi shumë më të mëdha që zinin vend në këtë ndërtesë. Këto fuqi datonin që nga viti 1955, duke dëshmuar se në këtë bodrum ishte punuar edhe para vitit 2006-të, kur ky vend rifilloi punën dhe jetën. Udhëtimi ynë i vogël vazhdoi duke mësuar shumë gjëra interesante. Aty për herë të parë mësova se vera e kuqe ishte një aleate e mirë kundër kancerit, infarktut, yndyrës së tepërt. Gjithsesi vera duhej të merrej në masë. Punëtorët na treguan se në një ditë preferohet një gotë me 400-600 mililitra verë. Ne e vizituam edhe laboratorin me kontrollet përkatëse të verës. Në atë laborator pata rastin të shoh disa mjete të panjohura më parë si spektrofotometri që shërbente për matjen e intensitetit të ngjyrës së verës.

Një gjë që më bëri përshtypje ishte fakti që ky bodrum prodhonte mjaft verë për Kosovën dhe e eksportonte atë në Ballkan e vende të tjera të Evropës. Ne pamë edhe makineri të tjera, brenda dhe jashtë dhe mësuam për dekantimin e presimin. Mësuam edhe se dioksidi i karbonit (CO2) e mbron verën, prandaj nuk duhet të largohet nga ajo. Pra siç mund të shihet, kjo vizitë ishte shumë e frytshme. Pasi bëmë një turne të plotë në këtë bodrum, ne u kthyem mjaft të kënaqur në shtëpitë tona. Për mua veçanërisht ishte një vizitë e qëlluar kjo që bëmë në bodrumin e verës në Rohavec. Përveç të tjerash mendoj se na tregoi se me dëshirë e vullnet mund të arrijmë shumë, por duhet punë, pasi edhe gjërat që në dukje janë të vogla, kërkojnë djersë dhe mund.



Konvikt

Kush jam unë? Eriola Morina VII b

Konviktore



Shumë herë njerëzit e kanë pyetur veten:
Pse jam kaq e bukur ... ose kaq e keqe?

Por kurrë nuk e kanë pyetur veten:
A jam e bukur apo e keqe në shpirt?

Unë për vete shumë herë kam thënë:
Pse jeta duhet të jetë kaq e brishtë për njerëzit?

Edhe pse të gjithë e dinë se bëjnë gabime, kurrë nuk u binden gjërave që të tjerët thonë. S'di sa herë e keni pyetur veten:
Pse shkoj në shkollë, kur mundem të luaj me shoqë dhe të rri në shtëpi?

Eh! Ka shumë që e kanë pyetur veten, por ka edhe shumë që e kanë provuar. Ata që e kanë provuar, tani s'kanë guxim ta pyesin veten:
Pse jam në këtë gjendje?

A thua sa njerëz kanë pyetur veten:
Pse po jetojmë?

Këtë me siguri e kanë pyetur ata që shumë mërziten nga jeta dhe që janë të trishtuar. Ndërsa ata që janë të lumtur dhe që duan të jetojnë, pyesin veten:
*Pse po jetojmë kaq pak ... ?
Kush jam unë?*

Ti je ajo që të tjerët s'dinë cila je!

Gënjeshtra Aurora Morina X d

Konviktore



*"Unë i shoh njerëzit më të etur për të zbuluar arsyt e një gjëje, se sa për ta vërtetuar nëse ajo gjë është e vërtetë".
Kështu ka thënë eseiisti francez, Michel de Montaigne.*

Unë pajtohem me të. Pse ekziston gënjeshtra? Për ta fshehur të vërtetën. Pse duhet ta fshehim të vërtetën? Sepse dikujt mund t'i duket e hidhur, sepse është argumenti më i fortë që ka ekzistuar deri më tani. Deri më tani thashë? Po, sepse sot, sidomos sot, gënjeshtra ka shtrirë rrënjët në çdo njeri. S'ka njeri që s'ka gënjyer së paku një herë në jetë. Por gënjeshtrat dallojnë. Ka disa gënjeshtra që të nxjerrin prej një situatë të vështirë për ty. Të padëmshme ndoshta.

Por tjetër gjë është të shpifësh, sepse gënjeshtra është shpifje. Pjellë e imagjinatës, ndonjëherë pjellë e një imagjinatë të prishur e cila nxjerr tinguj fyes që çënojnë identitetin e dikujt tjetër. Ndoshta ky dikush është pasqyrë shembulli për të mire, po ja që kjo pasqyrë mund të kthehet mbrapsht për shkak disa gënjeshtrave imorale. Për dikë, fjalët e së vërtetës janë paradoksale.

Ai që di të vërtetën, le ta shpallë atë pa pyetur kush e pranon e kush jo.

Internat

06.06.2009
Camping im Rugovatal
Filomena Laci

Das Ende der Woche näherte sich. Wir waren gestresst von vielen Tests. So beschlossen wir, die Internatsschüler aus der XII. Klasse und unsere Erzieher, in Rugova zu campen.

Am Samstag nach der Abiturprüfung bereiteten wir uns auf die Fahrt vor. Den ganzen Weg lang redeten wir darüber, was wir in der Prüfung gemacht hatten. Aber das alles endete, als wir in Rugova (Guri i Kuq) ankamen. Wir waren alle gut drauf und wollten einfach nur Spaß haben. Es hat sehr viel Spaß gemacht, draußen zusammen zu essen. Danach haben wir noch ein Lagerfeuer gemacht, Gitarre gespielt und dazu gesungen. Es war wirklich schön.

Dann gingen wir alle in unsere Camphäuser, um uns auszuruhen, da wir am nächsten Morgen zu einem See in den Bergen wandern wollten. Als wir am See ankamen, waren wir total erschöpft, aber es hatte sich gelohnt, denn es war sehr schön dort oben. Als wir zu unseren Camphäusern zurück kamen, packten wir unsere Sachen und machten uns auf den Weg nach Hause (ins Internat).

Wir hatten sehr viel Spaß, so wie in einer großen Familie.



Kampingu në Rugovë

Po afrohej fundi i javës. Ishim lodhur me teste e me stres. Kështu, për pushim vendosëm që ne maturanët që jemi në konvikt, bashkë me edukatoret tona, të organizonim një kamping në Rugovë.

Të shtunën pas testit kombëtar që patëm, u bëmë gati dhe u nisëm. Gjatë tërë rrugës bisedonim e pothuajse e brengoseshim se çfarë kishim bërë në test. E gjitha kjo përfundoi kur arritëm te Guri i Kuq (vendi ku do të bënim kamping). Disponimi na ndryshoi dhe nuk menduam më asgjë, pos të kënaqeshim së bashku. Ishte një kënaqësi e vërtetë të bënim grill së bashku e të hanim një darkë modeste, por me shumë dashuri e buzëqeshje. Mëkat ishte të ktheheshim nga kampingu pa e ndezur zjarrin në mbrëmje e pa kënduar me kitarë! Ishte shumë bukur!

Ishim ulur rreth zjarrit të gjithë së bashku. Tingujt e kitarës na shoqëronin e buzëqeshja mbretëronte në sytë e secilit nga ne. Kaluam bukur që në fillim. Pastaj shkuam në vilat tona të flinim, sepse të nesërmen pas mëngjesit do të ngjiteshim më lart në bjeshkë të shijonim bukurinë e liqenit. U lodhëm shumë kur shkuam të nesërmen te liqeni, por u çlodhëm me bukuritë e tij. Pasi u kthyem sërish në vila, i mblodhëm gjërat e u nisëm për në konvikt.

E mira e gjithë këtij kampingu që se ne u kënaqëm dhe kaluam shumë mirë, sikur të ishim të një familje të vetme.



Konvikt

Kampingu në Rugovë



Konviktore



Përtej ...
Aurora Morina X d

Çdo ditë luftoj që ndjenjat të mos dalin mbi logjikën, por ato kalojnë tej e përtej. Kalojnë male, shkretëtira e hapësira të pakufishme. Arrijnë deri në kulmin e lumturisë, por unë dua majën e kulmit.

Ajo është aq e thepisur, sa frikësohem ta prek duke menduar se do të më kapë mallkimi që pret të hidhet mbi emrin tim. Pret që unë të bie në kurthin e gjilpërës shkëlqyese të lumturisë, që është e vetmja në humnerën që jam futur.

E shoh se si shkëlqen, megjithatë s'arrij ta kap. E shoh ... e shoh dhe vetëm e shikoj. Ky është destinacioni që duhet ta arrij. Diçka u përmbys. Një vull ndjenjash guximi u zgjuan nga gjumi dimëror në të cilin ishin futur. Po si duket, akulli u thye. Pa e vërejtur unë i afrohem majës dhe bëj hap ta kap ...

Jo, jo kjo është e pamundur. Përse më kalon përtej gishtave e s'e ndjej? Si është e mundur të jetë e padukshme kur unë e shoh jetën time në të?

Mbretëria ime e frikshme vazhdoi derisa më në fund hapa sytë. Gjithçka ndryshoi. Dallova se ka një tokë të të gjallëve dhe një tokë të të vdekurve. Unë isha në këtë të fundit, po u ktheva prapë këtu.

Këtu pashë jetën, pashë se ajo që ka vlerë është cilësia e jo sasia dhe gjithçka që kam unë është cilësore. Po këto cilësi

ishin larg, shumë larg nga syri im.

Isha thjesht në një qoshk të fantazisë sime, pa menduar se ajo më dërgoi larg, shumë larg nga realiteti në të cilin jetoj unë, në të cilin jetojmë të gjithë ne. Dhe realiteti është ky mjedis dhe këta njerëz që më rrethojnë.

Treni që më shëtiti në arenën e iluzioneve dhe fantazisë është një dell marrëzie i lezetshëm që vazhdon të sillet rreth stacionit, por kurrsesi të ndalet në të.



Bonton Filomena Laçi

Edukatore



Për cilësi më të mirë të edukimit të nxënësve të shkollës sonë, kemi rënë në dakord të mbahen orët e Bontonit.

"Erare humanum est" do të thotë: "Të gabosh është njerëzore", por ajo që më

së shumti vlerësohet te njeriu është edukimi dhe përmirësimi. Mënyra e sjelljeve në tavolinë është pjesë e kulturës, por edhe konsumimi i ushqimit të shëndoshë.

Pos teorisë, të gjitha i realizuam në praktikë. Me ndihmën e kuzhinierëve të KFOR-it gjerman. Së bashku çdo të dytën javë përgatisim një darkë solemne. Nxënësit ishin të ndarë në 4-grupe. Çdo grup udhëhiqej nga një kuzhinier gjerman. Një grup përgatiste paragjellën, tjetri-gjellën kryesore, tjetri ëmbëlsirën dhe më në fund dekorimi, shërbimi i tryezës.

Nxënësit me seriozitet të madh i përcillnin udhëzimet dhe këshillat. Një të shtunë, për t'i befasuar miqtë tanë, ne i përgatitëm shportat me anë të shpagetave dhe pinguinët nga vezët. Shumë mësuam nga ky shoqërim.



KFOR – Soldaten mit Kochmütze Heide Noll

"... und jetzt schön ausrollen". Das muss Feldkoch Matthias Gareis nicht näher erklären. Abwechselnd schieben Mädchen und Buben das große Nudelholz aus Edelstahl über den Teig. Zwischendurch kommt immer wieder Mehl drauf. Am Ende entsteht daraus ein Strudelteig. Die Äpfel für die Füllung haben die Kinder schon geschält, kleingeschnitten und mit Butter, Zucker und Zimt verrührt. Auf der anderen Seite der Küche schnippeln mehrere Jungen, was das Zeug hält. Sie verwandeln Zucchini und Möhren in "tourniertes", in Form gebrachtes Gemüse. Das gibt die Beilage zum Hauptgang, einem Rindersteak mit Champignonhaube, Rahmsauce und selbst geschnitzten Pommes Frites. Vorneweg füttern die 18 Schülerinnen und Schüler Mini-Pizzas mit Belag nach Wahl.

Seit März gibt es ein Projekt zwischen Loyola-Gymnasium und Bundeswehr, das allen Beteiligten viel Spaß macht. Jeweils vier Feldköche kochen mit einer Gruppe Schüler. Filip Marki und Albina Bisaku, die normalerweise für die Verköstigung der Internatsschüler sorgen und auch an diesem Tag für die Mehrheit kochen, schauen zu.



"Die Schüler stellen sich gut an", lobt Matthias Gareis. Der Koch freut sich darüber, dass ihn die Jugendlichen problemlos verstehen. Ebenso wie seine Kollegen Roland Machleb, Dominik Richter und Küchenmeister Thomas Redel genießt er es, mal aus dem Lager herauszukommen und etwas Besonderes zuzubereiten. Sein Alltag hat nämlich ganz andere Dimensionen. In zwei Schichten kochen zehn Feldköche jeweils 500 Portionen – "Da können wir nur weniger aufwendige Gerichte zubereiten", sagt Gareis.



Bei kleinen Gruppen, wie im Loyola-Gymnasium, ist Raum für schmackhafte Extras. Etwa die Champignonhaube auf dem Steak, die Anton aus der zwölften Klasse unter der Anleitung von Dominik Richter anrührt. "Es ist schön, wenn man den Jugendlichen etwas zeigen und vielleicht auch etwas bewirken kann", sagt Matthias Gareis. Die Kinder ihrerseits sind mit Feuereifer bei der Sache. Sie lernen zudem, dass gutes Essen nochmal besser schmeckt, wenn der Tisch ansprechend gedeckt ist. Die Mädchen und Buben, die in der Küche fertig sind, legen Tischdecken, Teller und Besteck auf, falten Servietten und freuen sich über Blumenschmuck auf dem Tisch. Am Ende sitzen alle Köche, kleine und große, an der Tafel und lassen sich ihr Drei-Gang-Menü schmecken. Die übrigen Schüler schauen ein bisschen neidisch hin.



Aber keine Sorge: Jeder kommt mal dran.

Kapsamun 18.05.2009 - Das Konzert Bardh Sokoli XII b



Meine Freunde, unsere Erzieherin und ich redeten über verschiedene Themen. Ein Thema davon war die Musik. Ein Freund sagte, dass er Konzerte und Live-Musik sehr mag. Als die Erzieherin das hörte, erzählte sie uns, dass ein Konzert mit der Schweizer Band Kapsamun in Prizren stattfinden wird.

Manche von uns freuten sich darüber und die anderen fingen an zu fragen: "Wer ist denn diese Band?" Einige, die die Band schon kannten, erzählten über die Band und deren Musik:

"Kapsamun ist eine Band, die aus 5 Mitgliedern - einem Albaner und vier Schweizern - besteht. Albanische Volksmusik mit feurigen Rhythmen - sehnsüchtige Balladen aus dem Kosovo - rasende, ungerade Taktarten aus dem Orient. Temperamentvoll gespielt mit dem offenen Geist des neuen Welt-Jazz, der für alles Raum lässt, was Tanzbein und Herz bewegt: In der Musik von Kapsamun sind auch Einflüsse von Salsa, Fusion, Nu-Jazz oder Drum'n'Bass zu hören. So entstehen die vielfältig inspirierten Eigenkompositionen, welche die traditionelle Musik des Kosovo in neuer Frische aufleben lassen und ein bunt gemischtes Publikum begeistern."

Viele wussten nicht, dass es albanische Jazz-Musik gibt. Sie waren neugierig. Wir beschlossen, in dieses Konzert zu gehen. Einen Tag vor dem Konzert gab unsere Erzieherin jedem von uns eine Eintrittskarte. Endlich kam der Tag und wir fuhren am Abend zu diesem Konzert. Außer uns gab es noch viele andere Leute, die vor dem Eingang warteten. Das Konzert fing an. Am Anfang sprach Arsim Leka, das albanische Mitglied der Band, zu den Besuchern. Er präsentierte die Gruppe und freute sich sehr, dass so viele Leute zum Konzert gekommen waren. Die Musiker begannen mit der Interpretation von Songs wie Bariu, Vallja, etc. Das ganze Publikum war von der Musik begeistert. Das Konzert dauerte eine Stunde. Nach einer halben Stunde gab es 15 Minuten Pause. Einige von uns nutzten die Möglichkeit, mit den Mitgliedern der Band zu reden und Fragen zu stellen. Wir erzählten ihnen, dass uns ihre Musik sehr gefällt und dass wir Schüler aus einem klassischen, privaten Gymnasium sind, wo auch Deutsch als Fremdsprache gelernt wird. Auch sie fanden es toll, dass es eine solche Schule im Kosovo gibt.

Als wir nach dem Konzert zurück ins Internat kamen, erzählten wir einander:

"Die Musik war echt toll, einfach super."

"Genau. Vor allem gefiel mir, dass unsere albanische Musik so gut in Jazz klingt."

Als wir nach dem Konzert zurück ins Internat kamen, erzählten wir einander:

"Die Musik war echt toll, einfach super."

"Genau. Vor allem gefiel mir, dass unsere albanische Musik so gut in Jazz klingt."

Kapsamun 18.05.2009 - Koncerti

Ishim e tërë shoqëria duke biseduar gjëra të ndryshme. Njëra prej temave ishte edhe muzika. Njëri nga shokët na tha se i pëlqente t'i vizitonte koncertet apo muzikën e gjallë. Me ne ishte edhe edukatorja. Pasi dëgjoji se ishim duke biseduar për koncerte dhe muzikë të gjallë, ajo menjëherë na informoi se në Prizren do të mbahej një koncert nga grupi muzikor zviceran "Kapsamun".

Disa nga ne u gëzuan kur e dëgjuan këtë lajm e disa fillonin të pyesin: "Kush është ky grup". Ata që e njihnin këtë grup filluan të tregonin për muzikën e këtij grupi dhe çdo gjë tjetër: "Kapsamun është grupi/bendi i përbërë nga 5 anëtarë - një shqiptar dhe katër zviceranë. Muzika e tyre është muzikë popullore shqiptare me ritme të zjarra. Me fjalë të tjera, muzika e tyre është muzikë jazz-shqiptare, ku pjesët muzikore tradicionale shqipe nga Kosova dhe Shqipëria përpunohen së bashku me muzikë të frymëzuar orientale, nga Evropa lindore. Muzika e këtij bendi ka në vete një melodi melankolike që është një ndihmesë e madhe për komunikimin mes dy kulturave."

Të gjithë u çuditën që vërtet po ekzistonte një muzikë jazz-shqiptare. Ishim kureshtarë. Vendosëm që grupi i klasave të XII-a, të shkonim në atë koncert. Një ditë para koncertit edukatorja na i solli biletat dhe të gjithë mezi prisnim të shkonim. Erdhi dita kur do të mbahej koncerti. Të gjithë u bëmë gati dhe në mbrëmje u nisëm për në Shtëpinë e Kulturës. Përveç nesh kishte edhe shumë adhurues të tjerë të cilët prisnin në radhë para hyrjes. Koncerti filloi. Së pari e mori fjalën anëtari shqiptar i grupit, Arsim Leka, i cili e prezantoi grupin dhe me disa fjalë na përshëndeti e u gëzua shumë që salla ishte e mbushur plot me adhurues. Muzika filloi me disa këngë hyrëse si: "Bariu", "Vallja", etj. I tërë publiku u magjeps me interpretimin e tyre. Koncerti zgjati 1 orë.

Gjysmë ore para se të përfundonte koncerti, ishte një pushim i shkurtër 15-minutësh. Disa nga ne e shfrytëzuan rastin të bisedonin me anëtarët e grupit dhe t'iu bënin pyetje për çdo gjë rreth tyre. Ne ju treguam se muzika e tyre na pëlqeu shumë dhe se ishim një grup nxënësish nga gjimnazi privat, klasik ku mësohet edhe gjuhë gjermane. Edhe atyre ju erdhi shumë mirë që në Kosovë kishte një shkollë të tillë.

Pasi përfundoi koncerti, të gjithë u kthyem në konvikt duke i thënë njëri-tjetrit:

"Muzika ishte shumë e mire. Diçka e mrekulueshme."

"Po, me të vërtetë më pëlqeu. Muzika jonë shqiptare tingëllon aq mirë në mënyrën jazz."



Ditura është mirëqenie Albina Marniku

Zbulimi më i madh që mund të bësh, është të vetëdijësohesh se brenda teje ka fuqi dhe mençuri të pafundme të cilat të aftësojnë për të përballuar çdo vështirësi, t'i bësh ballë çdo qëndresë dhe të zgjidhësh të gjitha vështirësitë që t'i vë jeta.

Ti ke lindur për të triumfuar, je pajisur me gjithë talentin dhe aftësitë e nevojshme për të manovruar me fatin dhe për të qenë Zot i fuqive të tua shpirtërore. Nëse nuk je i vetëdijshëm për fuqitë e tua shpirtërore, atëherë do të bëhesh lodër e ngjarjeve dhe e kushteve të mjedisit tënd dhe si pasojë, ke mangësinë e vetëbesimit, zhvlerësimin e vetvetes. Me fjalë të tjera; sa më pak që të jesh në dijeni për fuqinë shpirtërore, aq më shumë do të fitojnë fuqinë rrethanat e jetës kundrejt teje.

Andaj duhet të vëresh se në ty qëndron fuqia magjepëse e cila mund të të ngrejë lart në majën e lumturisë, shëndetit, lirisë dhe gëzimit të jetës, po qe se bëhesh i vetëdijshëm për efikasitetin e tyre dhe po deshe t'i fiksosh mendimet pozitive, sepse pasuria e ideve të pakufijshme në brendësinë tënde nuk shterron asnjëherë. Nëse njerëzit duan më shumë ar dhe argjend, me siguri se mund t'i përfitojnë nga elementet ekzistuese. Por inteligjenca e pafund i përmbush gjithnjë kërkesat e tua dhe është në natyrën e saj që gjithnjë të shihet që përmes teje të gjejë një mënyrë të të shprehurit më të mirë.

Andaj një mësim i mirë dhe një zbulim i vetvetës do të na ndihmonte t'i arrinim të gjitha gjërat që dëshirojmë në jetë.

Edukatore



Kultura e debatit Flodian Kuçi X d

Diskutimi është shkëmbim idesh midis dy ose më shumë personave mbi një temë të caktuar. Në shumë raste mendimet e pjesëmarrësve në debat nuk janë të njëjta, gjë që e bën debatin akoma më interesant. Zgjidhja më e mirë në lidhje me një temë të caktuar gjendet pas shkëmbimit të ideve të njerëzve të ndryshëm. Kjo është arsyeja pse debati është shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut.

Ç'ka na nevojitet për të marrë pjesë në diskutim?

Për të zhvilluar një debat sa më të mirë na nevojiten njohuri të mjaftueshme mbi temën në fjalë, njohje të normave demokratike si dhe pa dyshim na nevojitet etika e të shprehurit.

Njohuri të mjaftueshme mbi temën.

Asnjëherë mos jepni një mendim mbi një temë nëse nuk jeni i sigurtë se informacioni juaj është apo nuk është i saktë. Nëse përfshihen në një debat për letërsinë e në fakt nuk keni asnjë informacion në lidhje me letërsinë, atëherë ju vetëm do të dilni si figura negative e atij debati. Nëse jeni i interesuar për një temë e cila zhvillohet në debat dhe dëshironi të mësoni më tepër në lidhje me atë temë, atëherë do të ishte shumë më e udhës që të dëgjoni në fillim dhe pastaj të benit pyetje në lidhje me atë temë, se sa të inkuadroheni pa pasur informacionin e duhur. Mos ngurroni që të shprehni mendimin tuaj në një debat ose që t'i viheni kundër një mendimi që ju mendoni se nuk është i saktë. Mirëpo ju gjithmonë duhet të jeni i kujdesshëm që mendimin tuaj ta argumentoni me fakte të ndryshme. Në këtë mënyrë do të jeni bindës dhe komenti juaj do të ketë një vlerë në atë temë.

Njohja e normave demokratike dhe e etikës së të shprehurit.

Të jesh njeri i ditur është vetëm njëra anë e medaljes. Të dish ta shprehësh në mënyrë më të mirë diturinë tënde, është ana tjetër. Po aq i rëndësishëm sa mendimi që e shprehni është edhe mënyra si e shprehni. Gjithmonë diskutoni mbi temën e jo mbi personin. Një shprehje e famshme thotë: "Njerëzit e mëdhenj diskutojnë mbi idetë, njerëzit mediokër diskutojnë mbi ngjarjet, njerëzit e vegjël diskutojnë mbi njerëzit!" Kjo është një barometër për të matur kulturën e secilit nga debatuesit.

Duhet që ta respektoni bashkëbiseduesin si dhe mendimet e tij. Respekto, të të respektojnë. Asnjëherë mos tentoni që ta poshtëroni ose ta injoroni personin për të cilin po flisni ose me të cilin jeni duke folur. Argumentoni dhe mos komentoni. Është një gjë shumë e mirë kur ju e shprehni mendimin tuaj në një debat, por kjo nuk mjafton për të mbrojtur mendimin tuaj. Ju patjetër duhet të keni argumente që e argumentojnë atë.

Jo të gjithë e gëzojnë kulturën e duhur. Do të thotë që në një debat ju mund të hasni shpeshherë njerëz që nuk kanë njohuri për rregullat themelore të zhvillimit të një debati. Prandaj injoroni në heshtje personat që nuk e gëzojnë kulturën e duhur, pasi po u konfrontuat me mendimin e tij, atëherë do ta ulni veten në një nivel me të.

Rotacioni njëditor Donik Karaqi XI a

Konvikt



Gjithçka fillon në orën 6:45 me thirrjen edukatorëve për zgjim dhe urimin për një ditë të mbarë. Shpeshherë edhe rrezet e diellit që depërtojnë nëpër dritaret e konviktit na motivojnë për të filluar një ditë të suksesshme.

Dhomat lihen pastër për ta përmbushur kushtin higjienik, kurse në vazhdojmë drejt mensës rreth orës 7:20. Shujta e shijshme e mëngjesit vetëm sa na e shton oreksin për mësim. Pasi të marrim pak ajër të freskët në oborrin e shkollës, shpejt vjen koha që të fillojë mësimi. Në rresht dy nga dy, uniforma e kompletuar dhe një përshëndetje janë si kod për të hyrë në objektin shkollor të "Loyola-Gymnasium".

Në shkollë gjithçka fillon me saktësi. Pikërisht në orën 8:00 fillon mësimi dhe më pas vazhdojnë orët e tjera, gjithashtu me rregull. Pas orës së tretë mësimore vjen një freskim i shumëpritur, pra pushimi i gjatë 20 minutësh. Ky pushim shfrytëzohet në mënyra të ndryshme, varësisht prej nevojave të nxënësve. Disa hanë ushqim, disa mësojnë, disa luajnë, kurse disa bisedojnë me njëri-tjetrin. Pas pushimit gjithçka fillon normalisht, të freskuar nga orët e mëparshme.

Pas orës së gjashtë, në orën 13:10 kryhet mësimi dhe nxënësit që udhëtojnë i presin autobusët për të shkuar në shtëpi, kurse për konviktorët dita sapo ka filluar në mënyrë tjetër. Konviktorët pas mësimit shkojnë në konvikt ku i presin edukatorët e tyre. Nxënësit në konvikt janë të ndarë në grupe, varësisht prej gjinisë dhe moshës. Dreka e përgatitur shijshëm nga kuzhinierët tanë na çlodh shumë dhe na jep energji për pjesën tjetër të ditës.

Koha prej orës 14:00 deri në orën 16:00 është kohë e lirë dhe shfrytëzohet në mënyra të ndryshme. Disa i vizitojnë familjarët, disa merren me aktivitete, disa mësojnë, kurse disa e gjejnë si kohën më të përshtatshme për gjumë. Në orën 16:00 fillon mësimi individual i përcjellë nga edukatorët. Pas një orë mësimi, nxënësit për pushim marrin ndonjë frut si marendë. Pas marendës, në orën 17:30 vazhdon mësimi deri në 18:30, me mundësi bashkëpunimi me shokun ose punë grupore. Rreth orës 18:35 fillon



shujta e darkës, për ta përmbyllur edhe shujtën ushqimore të ditës. Pas darkës vazhdojnë aktivitetet e lira të përcaktuara me orar. Fushat sportive në nivele dhe standarde shumë të larta lejojnë mundësi zgjedhjeje të sportit (basketboll, futboll, ping-pong, volejball etj.).

Pra, në këtë kohë, secili nxënës mund të përqendrohet në pjesën që dëshiron qoftë ajo sportive, mësimore apo e lirë. Pas aktiviteteve që përfundojnë në orën 20:45 edukatorët bashkë me nxënësit hyjnë nëpër konviktet përkatëse dhe bëhen gati për kohën e gjumit. Celularët dorëzohen në orën 21:30 dhe merren të nesërmen në orën 14:00. Në orën 22:00 duhet të mbizotërojë qetësia e natës.

Përpos ditëve të zakonshme, gjatë qëndrimit dyjavor në konvikt organizohen aktivitetet tërheqëse si: dalja të shtunave në mbrëmje në qytet në mënyrë të organizuar, ekskursionet e ndryshme, turnetë sportive e shumë e shumë gjëra të tjera interesante.

Falenderoj stafin e edukatorëve dhe mesimdhënësve për trajtim individual për secilin nxënës dhe hapësirën e madhe që na lejohe për shprehjen e talenteve tona!



Ike larg Doruntinë Ahmetaj VIII a

Ike larg

U bëre engjell pa dëshirë,

*u vëshke pa çelur mirë.
Ike pa më thënë lamtumirë.
Shkove pa të njohur mirë.*

*Shtegtove pa trokitur vjeshta
dhe s'u ktheve kur të desha.
Një yll për ty u shua
dhe një engjell u zgjua.*

*Shoh qiellin dhe mendoj:
"Një ditë a do të t' takoj,
apo gjithmonë do të kujtoj
dhe përherë do të t'kërkoj?"*

*Ku të mbeti rruga jote?
Ku u tret ëndrra jote?
Ku gjendet dëshira jote?
Ku u zgjua flaka jote?*

Konvikt



Ndërgjegjia Flodian Kuçi X d

Në botë ka aq shumë njerëz dhe aq shumë veprime të kryera nga ata, saqë do të ishte e pamundur të jepet një vlerësim ose një ndëshkim për çdo veprim që ata kryejnë. Për këtë arsye Zotit i krijoi njeriut ndërgjegjen, sistemin e vetëvlerësimit ose vetëndëshkimit.

Njeriu, ndërgjegjia e të cilit është e pastër, ka një vlerësim të lartë për veten e tij. Kjo do të thotë se ai do të bindë Forcën e tij të Ndërdijes, e cila është "timoni i rrugëve njerëzore" dhe do të drejtojë timonin e tij drejt rrugës së suksesit. Ai me forcën e tij të ndërdijes do ta bindë veten se rrugët e tij të suksesit janë të hapura. Atij i duhet vetëm besimi në vetvete dhe drita e bardhë e Zotit që planet t'i realizohen për së mbari. "Mjafton ta mbjellësh farën dhe ta ujisësh, sepse rritja, lulëzimi dhe dhënia e frutave do të ndodhin vetvetiu". Tek njeriu fara (bërthama) e pemës është besimi në vetvete, kurse uji me të cilin ujitet pema është drita e Zotit që pershkon shpirtin e njeriut.

Mos ki frikë nga dështimi, sepse frika është reja që e mbulon dritën e Zotit dhe e fut suksesin tuaj në errësirë. Po me një njeri i cili ka shkelur lumturinë e një tjetri dhe nuk e ka ndërgjegjen e pastër, a thua çfarë do të ndodhë me të?

Vetëndëshkimi ose ndërgjegjia është ajo që do ta torturojë një njeri të tillë gjatë tërë jetës. Një njeri që ka kryer një mëkat të madh dhe tani jeton "nën prangat e përhershme" të ndërgjegjes së tij, do të fillojë që ta humbë dashurinë që të tjerët e kanë për të. Së bashku me dashurinë e të tjerëve, do ta humbë edhe vetëbesimin e tij. Do të vijë një kohë shumë shpejt kur ai do të fillojë urrejtjen për veten e tij. Ky është pikërisht lloji i njeriut që krijohet nga mëkati.

A ka lloj të njeriut më të dështuar se ai që s'ka besim në vete, që e urrejnë të tjerët e bashkë me të tjerët e urren veten?




Fjalët e shpirtit u bënë krahë Diana Kolaj

